

V E N D I M
Nr.129, datë 18.3.1999

**PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE
PËR TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 19 e 21 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

I. Procedura e dhënies së lejeve të tregtimit

Shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre, pajisen me leje tregtimi nga ministri që mbulon veprimtarinë hidrokarbure. Lejet e tregtimit janë të ndara në:

- a) leje të llojit “A”, që u jepet shoqërive për tregtimin e naftës e të nënprodukteve të saj, me përjashtim të nënprodukteve të destinuara për përdorim nga mjetet e fluturimit ajror;
- b) leje të llojit “B”, që u jepet shoqërive për tregtimin e gazit të lëngshëm;
- c) leje të llojit “C”, që u jepet shoqërive për tregtimin e nënprodukteve të naftës për mjetet e fluturimit ajror.

Dhënia e lejeve të tregtimit bëhet në bazë të procedurave të mëposhtme:

1. Subjekti paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hidrokarbureve kërkesën për marrjen e lejes së tregtimit, të specifikuar për kategorinë e produkteve që do të tregtojë.

2. Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën janë:

- a) Vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik.
- b) Certifikata e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe dokumenti i NIPT-së.
- c) Vërtetimi i pronësisë ose kontrata e qirasë për depozitat që do të përdorë subjekti.
- ç) Projekti teknologjik i depove e i linjave i miratuar nga zyra e urbanistikës, nga organet e mbrojtjes së mjedisit e ato të mbrojtjes nga zjarri, pranë njësive të qeverisjes vendore.
- d) Genplani për vendndodhjen e depove, i miratuar nga zyra e urbanistikës.
- dh) Certifikata e matjes së vëllimit të depove nga organet përkatëse të kalibrimit e të metrologjisë në njësitë e qeverisjes vendore.

e) Akti i kontrollit dhe leja e shfrytëzimit, të lëshuara nga zyra e urbanistikës.

ë) Vërtetimi bankar për depozitim të kapitalit minimal, sipas llojit të lejes.

f) Vërtetimi i pronësisë apo kontrata e marrjes në përdorim të mjeteve të transportit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve ushtron kontroll për verifikimin e të dhënave dhe të treguesve të paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.

4. Kur nga verifikimi i të dhënave dhe i treguesve rezulton se janë plotësuar kushtet e kërkuara, ministri jep lejen e tregtimit të specifikuar sipas kategorisë përkatëse të produktit që do të tregtohet.

5. Afati për ushtrimin e kontrollit dhe afati i lejes nuk mund të jetë më shumë se 60 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës së subjektit në ministri.

6. Kur nga verifikimi i të dhënave dhe i treguesve rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit, i cili mund t'i riparaqesë pas plotësimit të kushteve të kërkuara.

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa për stacionet e tjera nga organet e qeverisjes vendore, sipas kompetencës për dhënien e lejeve të ndërtimit.

1. Për marrjen e autorizimeve për stacionet e shitjes së karburanteve, subjekti duhet të paraqesë, pranë organit që ka në kompetencë dhënien e autorizimit, këto dokumente :

- a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik.

- b) Certifikimin e regjistrimit në zyrën e tatimeve.
- c) Projektin teknologjik të miratuar nga zyrat e urbanistikës, organet e mbrojtjes së mjedisit e ato të mbrojtjes nga zjarri në njësitë e qeverisjes vendore.
- ç) Certifikatën e kalibrimit të rezervuareve të vendosur në stacion dhe të matjes së aparateve të shitjes së karburanteve lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore.
- d) Aktin e kontrollit dhe lejen e shfrytëzimit të objektit të lëshuar nga zyrat e urbanistikës.
- dh) Vërtetimin për kontrollin e respektimit të kushteve teknike të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre
- 2. Organet që kanë në kompetencë dhënien e autorizimeve, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.
- 3. Kur, pas verifikimit, të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacion plotësojnë kushtet e kërkuara, organi përkatës jep autorizimin për ushtrimin e veprimtarisë në stacionin e shitjes së karburanteve. Afati për kontrollin e dokumentacionit dhe plotësimin e autorizimeve nuk mund të jetë më i madh se 15 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës në organin që ka në kompetencë dhënien e autorizimit.
- 4. Kur, pas verifikimit, të dhënat dhe treguesit nuk plotësojnë kërkesat, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparaqitjen e tyre.
- 5. Dhënia e autorizimeve për njësitë e shitjes së lëndës djegëse bëhet nga organet e qeverisjes vendore. Subjekti, që kërkon të pajiset me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse, duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) Vërtetimin për pronësinë apo kontratën për marrjen në përdorim të mjedisit përkatës.
 - b) Vërtetimin për respektimin e kushteve teknike të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.
 - c) Vërtetimin për respektimin e kushteve për mbrojtjen e mjedisit e ato të mbrojtjes nga zjarri, të lëshuar nga organet përkatëse në njësitë e qeverisjes vendore.
 - ç) Certifikatën e kalibrimit të enëve e të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore.
- 6 Afati për verifikimet e nevojshme dhe plotësimin e autorizimeve për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse nuk mund të jetë më i madh se 10 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës.
- 7. Kur nga verifikimet rezulton se nuk janë plotësuar kushtet e caktuara, dokumentet i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparaqitjen e tyre.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të tregtimit dhe e autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkuar.

Tarifat e pagesës kur lejet e tregtimit dhe autorizimet jepen për herë të parë janë:

- 1. Për lejet e tregtimit të llojit "A"- 500 000 lekë
- 2. Për lejet e tregtimit të llojit "B"- 200 000 lekë
- 3. Për lejet e tregtimit të llojit "C"- 200 000 lekë
- 4. Për autorizime për stacione shitjeje karburanti- 100 000 lekë
- 5. Për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse- 50 000 lekë

Tarifat për ripërsëritjen periodike të lejeve të tregtimit e të autorizimeve janë sa ½ e tarifave të mësipërme.

Të ardhurat që realizohen nga pagesat e tarifave të pikave 1, 2 dhe 3 do të përdoren 90 për qind nga ministria për financimin e Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre. Të ardhurat që realizohen nga pagesat e tarifave të pikave 4 dhe 5 do të administrohen në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

IV. Kushtet për pajisjen me leje tregtimi

1. Kapitali minimal, që duhet të ketë një shoqëri anonime në llogarinë e saj në bankë, në çastin e kërkesës për pajisjen me leje tregtimi, të jetë:

- për lejet e tregtimit të llojit "A" - 70 000 000 lekë.
- për lejet e tregtimit të llojit "B" - 30 000 000 lekë
- për lejet e tregtimit të llojit "C" - 30 000 000 lekë

2. Kapaciteti minimal i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi, sipas llojit të lejes është:

- Për lejet e tregtimit të llojit "A"

Kur leja jepet vetëm për një kategori produktesh, jo më pak se 7000 m³.

Kur leja jepet për më shumë se një kategori produktesh, jo më pak se 3000 m³ për çdo kategori produkti.

Depozitat, kur leja është e llojit "A" për disa kategori produktesh, duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra.

- Për lejet e tregtimit të llojit "B"

Për stacione depozitimi të palëvizshme, jo më pak se 400 m³

Për stacione depozitimi të lëvizshme, jo më pak se 100 m³

Depozitat si më sipër mund të jenë edhe më shumë se një, por me kusht

që çdo njëra prej tyre të plotësojë normat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit përkatës.

- Për lejet e tregtimit të llojit "C"

Kur leja jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 200 m³

Kur leja jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 1 000 m³

3. Shoqëritë anonime, që kërkojnë të marrin leje tregtimi duhet të kenë në pronësi ose në përdorim të tyre, në çastin e kërkesës për leje dhe gjatë gjithë kohës së veprimtarisë, jo më pak se 3 mjete transportuese për naftë, gaz apo nënprodukte të tyre me një kapacitet të përgjithshëm jo më të vogël se 60 m³. Këto mjete do të jenë të kalibruara nga organet përkatëse të metrologjisë e kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore, ku shoqëria ka selinë e vet. Kalibrimi duhet të bëhet për të treguar, në mënyrë të dallueshme, për çdo centimetër të lartësisë së çisternës, vëllimin e saj. Vëllimi, në tërësi, i çisternës duhet të jetë i shkruar, me stampim, në një pllakë metalike, me përmasa 10 cm x 10 cm, të vendosur në një pjesë të dukshme të çisternës.

4. Depozitat e subjekteve, që kërkojnë të pajisen me lejen e llojit "A" duhet të jenë të kalibruara nga organet përkatëse të metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore. Ato duhet të jenë të pajisura me peshore elektronike, për të matur çdo hyrjedalje të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre. Për depozitat bregdetare duhet të ketë mjete matëse dhe në vendin e ngarkim-shkarkimit të anijeve.

5. Për subjektet që kryejnë aktualisht veprimtarinë në fushën e tregtimit me shumicë të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, veprimtari që përfshihen në nenin 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" dhe që kërkojnë të vazhdojnë veprimtarinë, duhet :

a) të regjistrohen si shoqëri anonime;

b) të kenë personalitet juridik të veçantë nga stacionet e shitjes së karburanteve;

c) të plotësojnë kapitalin minimal, të përcaktuar në kreun IV pika 1 e këtij vendimi;

ç) të sigurojnë mjetet e transportit sipas përcaktimeve të kreut IV pika 3 e këtij vendimi.

6. Kërkesat e përcaktuara në pikën 5 duhet të plotësohen brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Ato subjekte, që i plotësojnë këto kushte, do të pajisen me leje tregtimi provizore deri në plotësimin e kushteve për depozitat.

7. Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse e i kalibrimit të tyre, duhet të plotësohen nga subjektet që kryejnë aktualisht veprimtarinë sipas nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Me plotësimin e këtyre kushteve jepet leja e tregtimit.

8. Lejet e tregtimit duhet të përmbajnë :

a) numrin e lejes dhe datën e lëshimit të saj;

b) emrin dhe selinë e subjektit që merr lejen;

c) llojin e lejes dhe kategorinë e produktit që do të tregtohet;

ç) afatin e vlefshmërisë së lejes;

d) vendndodhjen e depozitave;

dh) llojin dhe afatet e informacionit që duhet të dërgojë në ministri;

e) sasinë e rezervës së sigurisë.

9. Të dhënat e përcaktuara në shkronjat a, b, c, d, e, të pikës 8 të këtij vendimi janë të vlefshme edhe për autorizimet.

V. Hartimi i kushteve teknike

1. Kushtet teknike, që duhen respektuar në të gjitha pajisjet, impiantet, instalimet, stacionet,

repartet dhe linjat teknologjike përcaktohen me urdhër të ministrit që mbulon veprimtarinë hidrokarbure, brenda 45 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.

2. Kushtet teknike janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Ministria që mbulon veprimtarinë hidrokarbure të publikojë kushtet teknike.

VI. Heqja e lejeve të tregtimit e të autorizimeve

Në rast përsëritjeje të shkeljeve të përcaktuara në ligj, organi kompetent ka të drejtën e heqjes së lejes së tregtimit apo autorizimit përkatës për ushtrimin e veprimtarisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko